

*mag*DA

Dialogue Academy Magazine

EDICIONI I 3-TË TETOR, 2025

**NE U JAPIM ZË HISTROIVE QË
FORMËSOJNË TË ARDHMEN TONË**



Përmbajtja

05 _____

LETËR PËR LEXUESIN

06 _____

MES MUREVE DHE HORIZONTEVE

Desantila Muriqi

08 _____

ECJA NËPËR VIJËN E HOLLË

Davor Džakula

11 _____

**FJALËKRYQ RPS:
FJALËT E PAQES**

12 _____

KUFIJTË NDAJNË, MIQËSITË BASHKOJNË:
RINIA ËSHTË AJO QË NDRYSHON BOTËN

Marija Jovanović

13 _____

KUR URAT NUK MJAFTOJNË

Ardita Xhemajli

15 _____

DITA KUR BOTA NUK ISHTE MË KAFAZ

Hassina Akbari

16 _____

ORGANIZOHUNI MË ME ZGJUARSI: CILAT JANË JEHONAT
E FORUMIT STRATEGJIK TË BLEDIT?

Lazar Simić

19 _____

**DEKODERI I TERMAVE YPS:
A MUND T'I PËRPUTHNI FJALËT E PAQES?**

20 _____

HESHTJA E SIKLETSHME
E PANELEVE TË TË RINJVE NË PAQE

Alba Jakupi

23 _____

E SKLLAVËRUAR

Mihane Hoxha

24 _____

HAPËSIRAT E PËRKATËSISË:
QENDRAT RINORE,
ARKITEKTURA DHE PJESËMARRJA

Orgesa Gashi

28 _____

PA DREJTËSI, NUK KA PAQE:
MËSIME NGA PROTESTAT E STUDENTËVE

PSE STUDENTËT PROTESTOJNË

PROTESTAT SI MJET PËR NDËRTIMIN E PAQES

Andrijana Milojević

32 _____

REBELIM... APO THJESHT EKZISTENCË?

Albina Kastrati

35 _____

**NJË FJALË
TRE GJUHË**

*Kjo iniciativë zbatohet nga ish-studentet e Akademisë së Dialogut me mbështetjen financiare të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura janë të autorëve dhe kontribuuesve dhe nuk pasqyrojnë medoemos qëndrim zyrtar të OSBE-së ose të Misionit në Kosovë. Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GjND-së mbi Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.



Të dashur lexues,

Mirë se vini në botimin e tretë të *Revistës së Akademisë së Dialogut, MagDA!*

Ky botim i kushtohet Agjendës së Rinisë, Pages dhe Sigurisë (RPS), thirrje kjo globale e cila e njeh rolin thelbësor që luajnë të rinjtë në formësimin e shoqërive për ti bërë ato paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse.

Përgjatë leximit të revistës do të "dëgjoni" e shihni zërat, idetë e kreativitetin e të rinjve dhe të rejave të cilët vazhdojnë t'i sfidojnë stereotipet dhe të parafytyrojnë mundësi të reja për dialog dhe bashkëjetesë. Nga ripërcaktimi i asaj çfarë do të thotë pjesëmarrja e vërtetë, deri te adresimi i heshtjeve që shpesh i rrethojnë të rinjtë në hapësirat e vendimmarrjes, ky botim sjell reflektime që janë si të guximshme e shpresëdhënëse.

Nëpërmjet eseve, ilustrimeve, intervistave dhe poezive, të rinjtë ndajnë me ne sfidat dhe mundësitë që burojnë nga përkushtimi për pagën. Duke sfiduar pritshmëritë e shumicës dhe dyert që i mbajnë ende jashtë hapësirave ku merren vendimet. Qoftë në kapërcimin e ndarjeve ndërbreznore, në rimendimin e hapësirave qytetare apo në fuqizimin e rolit të rinisë në proceset lokale e rajonale, këto shkrime na kujtojnë se agjenda RPS-së nuk është një koncept abstrakt, por një realitet i përditshëm që jetohet dhe mishërohet çdo ditë.

Shpresojmë që ky botim të nxisë dialogun dhe veprimin, duke na frymëzuar të gjithëve që t'i shohim të rinjtë jo vetëm si udhëhegës të ardhshëm, por edhe si aktorë të së tanishmes të cilët veçse kanë nisur formësimin e rrugës drejt pages, përfshirjes dhe drejtësisë.

Me solidaritet dhe forcë,

EKIPI I
magDA-s
Dialogue Academy Magazine

Aida Fejzullahu, redaktore, Alumni e AD-së 2023

Anja Anđušić, redaktore, Alumni e AD-së 2019

Marija Jovanović, redaktore, Alumni e AD-së 2019

Nën udhërrëfimin e

Alba Jakupi, DA Alumna 2018

MES MUREVE DHE HORIZONTEVE

AUTORE: *Desantila Muriqi*

Rinia shpesh përshkruhet si koha e mundësive, e energjisë, ideve dhe të ardhmeve që ende presin të shkruhen bashkë. Ajo që nuk thuhet është sa e rëndë mund të ndjehet kjo mundësi në një rajon ku muret janë më të vjetra se ëndrrat tona, dhe ku shpresa duhet rindërtuar çdo ditë; një peshë që e kemi ndier nga afër – që na ka formësuar, na ka lënduar, por edhe na ka forcuar.

Në çarjet e atyre mureve të vjetra, të rinjtë e rajonit e gjejnë njëri-tjetrin. Disa ditë duket sikur po formësojmë diçka të vërtetë nga guri. Ditë të tjera, sikur po ndjekim një ëndërr që na rrëshqet ndër gishta. Takon njerëz që i do me gjithë zemër. Ëndërroni bashkë. Zemëroheni bashkë. Luftoni për të ndryshuar diçka. Dhe pastaj përplaseni me murin. Ka çaste kur ndjenja e pafuqisë të mbulon plotësisht; aq sa kërkon çdo mënyrë për të rimarrë ndjenjën e kontrollit. Sepse mëson sa i brishtë është përparimi: vite përpjekjeje mund të shemben me një vendim, me një nënshkrim të vetëm.

Në një moment të caktuar, lodhja të bën të vësh në dyshim gjithçka - nëse puna jote ka vlerë, nëse ndikon te dikush. Më e vështira nuk është pesha e politikës, por ndjenja se ajo është e vetmja gjë që peshon. Prandaj kthehesh tek ajo që ende e ke në duar. Vazhdon të bësh çfarë mundesh, aty ku je, me mjetet që ke. Mbjell fara dhe i beson procesit. Dhe i premtos vetes se kur të vijë koha, kur të kesh më shumë fuqi, do ta përdorësh për të krijuar hapësirë. Që të rinjtë të mos kenë pse të presin për t'u marrë seriozisht. Që të tjerët të rriten pa ndier se po fshihen. Sepse tani është radha jote të çash përmes çarjeve, të lejosh dritën

të hyjë, dhe t'i shembësh muret nga brenda.

Por pastaj fillon të pyesësh veten: a do të vijë ndonjëherë ajo kohë? Fillon të dyshosh nëse ajo që po jeton është e vërtetë, apo vetëm një iluzion i brishtë, i mundësuar nga qëndrimi brenda një flluske. Një flluskë shpresëdhënëse, por e cila për shumëkënd mbetet e paarritshme. Mendimet të shkojnë te të gjithë të rinjtë që nuk e përjetojnë kurrë atë ndjenjë shprese. Disa e shohin bashkëpunimin rajonal me dyshim, të tjerë e mohojnë plotësisht. Shumë mbeten të ngujuar në cikle nga të cilat nuk mund të çlirohen — cikle të ndërtuara mbi narrativa të trashëguara dhe ndarje të pazgjidhura, që shumica prej nesh nuk i kemi jetuar, por që ende i mbajmë sikur të ishin tonat. Për ta, shpesh duket sikur ekziston vetëm një zgjedhje: vendi ose rajoni. Në sytë e tyre, besnikëria nuk mund të shtrihet aq larg sa t'i përfshijë të dyja. Ideja se një identitet rajonal mund të bashkëjetojë me përkatësinë kombëtare, apo edhe me aspiratën evropiane, u tingëllon si tradhti. Dhe kështu, hapësira ngushtohet. Frika zë vend. Muret mbeten të pashëmbura.

Atëherë fillon të marrë formë një lloj i ri i asaj që quhet “ne kundër tyre” - jo përgjatë vijave etnike apo kombëtare, por në mënyrën se si zgjedhim ta shohim rajonin. A duhet të përballemi me të kaluarën apo t'ia kthejmë shpinën? A besojmë në pajtim apo mbajmë distancë? A ta mbajmë shpresën fort, apo ta lëmë të shkojë.

Përpiqesh të jesh përfshirës. Përpiqesh të shpjegosh, të krijosh hapësirë, të kapërcesh hendekun. Por shpesh, duket sikur nuk ke ndikim te askush. Narrativat që ndajnë janë

më të zhurmshme, më të njohura dhe më të lehta për t'u pranuar. Ato kërkojnë më pak pyetje dhe i shërbejnë një qëllimi më shumë politik. Ndonjëherë, edhe integrimi evropian - i ashtuquajturit horizont i përbashkët - nuk i bashkon më njerëzit. Disa nuk e shohin fare lidhjen; ata e trajtojnë rajonin si diçka të ndarë, të parëndësishëm. Të tjerët, të formësuar nga zhgënjimi, humbja e iluzioneve dhe ngecja, nuk besojnë më se kjo kishte ndonjëherë ndonjë kuptim. Përpiqesh të flasësh gjuhën e krijimit të raporteve, por të duket sikur të tjerët po të dëgjojnë gjithnjë e më pak. Dhe kur kjo ndodh, hapësira nuk rritet. Tkurret. Hendeku nuk mbyllet. Thellohet.

Megjithatë, përpiqemi. Sepse e dimë peshën që ka. Rritemi me kufij që mëtojnë të tkurren - mure që e kanë shenjë se ku përfundojmë ne dhe ku fillojnë të tjerët. Edhe kur i shtyjme, ata qëndrojnë. Disa mbështeten në to, si udhërrëfyes; të tjerët i testojnë skajet e tyre. Megjithatë, këto mure formësojnë mënyrën se si e shohim njëri-tjetrin, sa shumë i besojmë njëri-tjetrit dhe si e imagjinojmë vendin tonë në këtë rajon. Pastaj ka një tjetër tërheqje: premtimi për perspektivë Evropiane. Për shumë prej nesh, ky vizion duket real. Sepse na jep diçka tjetër për t'u mbajtur fort, një arsye për të besuar se ndryshimi është i mundur.

Ndonjëherë, pa paralajmërim, diçka hapet. Një tubim. Një bisedë. Një heshtje e përbashkët. Dhe në atë hapësirë, e kupton se nuk je vetëm. Ende ka njerëz që besojnë se rajoni mund të jetë më shumë sesa ajo që ka kaluar. Njerëz që guxojnë të imagjinojnë një rajon ku vendet bashkëpunojnë, ku pajtimi

përjetohet dhe ku të drejtat e njeriut respektohen. Edhe nëse ata zëra nuk janë gjithmonë më të zhurmshmit, ata janë prapë aty, duke zënë hapësirë, duke u shfaqur.

Sepse identiteti rajonal ka rëndësi - në të gjithë kompleksitetin e tij. Është i shtresuar, konfliktual, i brishtë, i formësuar nga e kaluara me të cilën ende po merremi dhe të ardhmen që ende po e negociojmë. Por është gjithashtu plot kuptim, në momentet e njohjes, në mirëkuptimin e pathënë, në kuptimin që diçka na lidh edhe kur gjithçka tjetër përpqet të na ndajë. Si të tillë, ne flasim. Sepse bashkëpunimi i të rinjve na dha njëri-tjetrin. Dhe nga kjo, diçka fillon të ndryshojë. Në pyetjet, që fillojmë t'i bëjmë. Në hapësirat që ngadalë mësojmë të mbajmë, për veten tonë dhe për njëri-tjetrin.

Dhe ndoshta ky është qëllimi. Jo se të rinjtë do t'i zgjidhin të gjitha, ose se muret do të shemben nesër, por se refuzojmë të ndalojmë së përpjekuri. Guxojmë të këmbëngulim në përkatësinë e të dy vendeve tona, rajonit tonë dhe Bashkimit Evropian, të vetes dhe të njëri-tjetrit. Në një botë që ndahet shpejt, mbajtja e hapësirës së përbashkët mund të jetë gjëja më radikale që bëjmë. Dhe ndoshta, do të jetë e mjaftueshme për t'i bërë muret të dridhen. Derisa një ditë, kur ato më në fund shemben.

ECJA NËPËR VIJËN E HOLLË

AUTOR: Davor Džakula

Ende e mbaj mend herën e parë që dikush më pyeti, "Çka je ti, në të vërtetë?"

Ata nuk po më pyesnin për hobit apo ëndrrat e mia, por për identitetin tim. Të rritesh me nënë myslimane dhe baba ortodoks/katolikë do të thotë se këto pyetje nuk ishin kurrë abstrakte. Ato ishin pjesë e jetës së përditshme, të thurura në gjuhë, tradita dhe tensione të heshtura që formësonin shoqëritë tona. Për mua, të jetuarit në mes ishte më pak barrë dhe më shumë ftesë: për të dëgjuar, për të pranuar kontradiktat dhe për të imagjinuar ura aty ku të tjerët shihnin mure.

Megjithatë, u rrita në një mjedis mjaft homogjen, ku diversiteti shpesh ndihej i largët, madje i keqkuptuar. Kjo i bëri takimet me njerëz nga prejardhje të tjera më sfiduese dhe më transformuese. Shkëmbimet rinore dhe projektet rajonale më hapën sytë ndaj realiteteve që qyteti im i lindjes nuk mundi të mi ofronte kurrë. Mësova se identiteti nuk është kategori fikse, por hapësirë dialogu, negociatash dhe ndonjëherë edhe shërimi.

Atëherë, nuk e mendoja veten si ndërtues paqeje. Isha thjesht pjesëmarrës, kureshtar për t'i takuar të tjerët. Megjithatë, ato momaente mbollën farën e asaj që do të bëhej misioni im. Me kalimin e kohës, u zhvendosa nga pjesëmarrës në organizator, nga dikush që merrte pjesë në biseda, në atë që i udhëhiqte ato, e më pas në koordinimin e projekteve që u jepnin të tjerëve të njëjtat mundësi.

Duke qenë se vij nga një prejardhje e përzier, shpesh vendosesh në rolin e urës lidhëse. Ndonjëherë, kjo ishte barrë e rëndë. Ndihesha sikur nuk i përkisja asnjë vendi. Por kjo barrë më ka dhënë edhe një dhuratë

të çmuar: të ndiej historitë e të tjerëve, të dëgjoj përpara se të gjykoj, dhe të shoh hijet mes dritës dhe errësirës.

Ky dualitet formësoi jo vetëm botëkuptimin tim personal, por edhe rrugën time profesionale. Në një rajon aq kompleks sa Ballkani Perëndimor, identiteti mund të bëhet lehtësisht vijë ndarëse. Megjithatë, mund të bëhet edhe pikë takimi. Historia ime është një ndër shumë shembuj që dëshmojnë se pajtimi nuk është vetëm një qëllim politikash. Është një përvojë e jetuar - e brishtë, por e vërtetë - nga mijëra të rinj që mbajnë bagazhe të shumta.

Derisa po studioja gjeografinë në Novi Sad, fillova të vërej se si peizazhet nuk janë kurrë vetëm fizike. Ato mbartin kujtime, kufij dhe vija të padukshme ndarjeje. Më vonë, gjatë studimeve të masterit në demokraci dhe të drejta të njeriut, gjeta fjalët për atë që kisha ndjerë tashmë. Transformimi i konflikteve dhe të drejtat e njeriut nuk janë koncepte abstrakte, por realitete të jetuara në rajonin tonë. Këto studime më lidhën gjithashtu me bashkëmoshatarë nga e mbarë bota, duke më kujtuar se luftërat e Ballkanit jehojnë shumë përtej kufijve të tij.

Puna ime në projektet mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe nxehtësisë urbane në Novi Sad, Shkup dhe Zagreb më ndryshoi pikëpamjen për paqen. Deri atëherë, e mendoja paqen kryesisht si dialog. Megjithatë, përballja me realitetin e ndryshimeve klimatike më tregoi se paqja varet edhe nga mënyra se si e trajtojmë nxehtësinë, ndotjen e ajrit ose mënyrën se si marrin frymë qytetet tona. Për mua ishte e qartë se agjenda e RPS-së nuk mund të kufizohet vetëm në konfliktet tradicionale. Duhet gjithashtu të përqafojë mjedisin dhe qëndrueshmërinë, sfidat që formësojnë të

ardhmen tonë të përbashkët.

Nga iniciativat lokale, përfundimisht e gjeta veten në forume ndërkombëtare, duke përfaqësuar perspektivat e të rinjve si pjesë e Grupit të Ekspertëve të Rinj të OSBE-së dhe duke folur në Forumin Rinor të OSBE-së në Helsinki. Duke folur para diplomatëve dhe politikëbërësve, mendja më kthehej shpesh te ai versioni im adoleshent, i pasigurt, por plot kureshtje. Udhëtimi midis atyre dy momenteve nuk ishte i lehtë — ishte plot dyshime, gabime dhe mësim. Por më mësoi se si pjesëmarrja e të rinjve mund të rritet natyrshëm, nga takimet lokale deri në biseda globale.

Këto përvoja më bindën se të rinjtë nuk janë vetëm përfitues të programeve të tilla; ne jemi partnerë dhe udhëheqës në formësimin e paqes. Kur flisja në Vjenë apo Helsinki, nuk flisja vetëm për veten time. Mbartja e zërave të të rinjve që takoja në Shabac, Shkup, Sarajevë e Novi Pazar më kujtonte se dimensionet lokale dhe globale nuk janë kurrë të ndara. Ndryshimi i klimës nuk njeh kufij — dhe as ndërtimi i paqes nuk duhet t'i njohë.

Integrimi i Agjendës së Gjelbër në bashkëpunimin rinor ka qenë një nga pjesët më frymëzuese të rrugëtimit tim kohët e fundit. Ajo lidh breza të tërë studentësh, mësuesish dhe politikëbërësish në të gjithë rajonin rreth çështjeve që na prekin të gjithëve. Agjenda e Gjelbër e riformulon pajtimin: bashkëpunimi nuk ka të bëjë vetëm me tejkalimin e ndarjeve të së kaluarës, por edhe me përbashkimin e së ardhmes së përbashkët.

Duke parë prapa, ndiej se kam ecur përgjatë një kufiri të hollë midis identiteteve, roleve dhe hapësirave lokale e globale. Ndonjëherë ndihesha i pasigurt, por shpesh ai ekuilibër më jepte forcë dhe perspektivë. Më lejoi të flas si i ri nga rajoni — dhe njëkohësisht si dikush që kontribuon në formësimin e politikave.

Agjenda për të Rinjtë, Paqen dhe Sigurinë, në shumë mënyra, ndjek të njëjtën linjë. Ajo na fton t'i shohim të rinjtë jo si probleme që duhen menaxhuar, por si partnerë të denjë për besim. Na sfidon t'i shohim jo vetëm si nxënës që kanë ende për të mësuar, por edhe si mësues që kanë çfarë të mësojnë të tjerëve.

Nëse ka një mësim që e marr nga rrugëtimi im, është se rrëfimet kanë rëndësi. Institucionet dhe strategjitë janë thelbësore, por ajo që ndryshon vërtet zemrat dhe mendjet janë përvojat e jetuara të të rinjve që refuzojnë të përcaktohen nga përçarjet.

Agjenda për Rini, Paqe dhe Siguri nuk është rezolutë abstrakte. Ajo merr formë në fytyrat e atyre që guxuan të takoheshin përtej kufijve, në mësuesit që frymëzuan brezat e rinj dhe në historinë time të navigimit përmes identiteteve.

Në fund të fundit, besoj se mjeti më i fuqishëm për ndërtimin e paqes është guximi për t'i treguar rrëfimet tona, dhe për t'i dëgjuar ato të të tjerëve.


Kjo, mbase, është fryma e vërtetë e saj: njohja e të rinjve jo vetëm si krijues të ndryshimit, por si ura të gjalla mes së kaluarës dhe së ardhmes, mes ndarjes dhe pajtimit, mes brishtësisë dhe shpresës. **Ndoshta pyetja e vërtetë nuk është nëse të rinjtë mund të ndërtojnë paqe — por nëse paqja mund të ekzistojë fare pa ta.**



Kjo, mbase, është fryma e vërtetë e saj: njohja e të rinjve jo vetëm si krijues të ndryshimit, por si ura të gjalla mes së kaluarës dhe së ardhmes, mes ndarjes dhe pajtimit, mes brishtësisë dhe shpresës.

Ndoshta pyetja e vërtetë nuk është nëse të rinjtë mund të ndërtojnë paqe — por nëse paqja mund të ekzistojë fare pa ta.





Rinia, Pajja dhe Siguria

- MagDA - 3rd Edition**

KUFIJTË NDAJNË, MIQËSITË BASHKOJNË:

RINIA ËSHTË AJO QË NDRYSHON BOTËN

AUTORE: Marija Jovanović

Ky poster ilustron fuqinë e lidhjeve të të rinjve përtej kufijve. Duke qenë foto e tri vajzave, e bërë në Irlandën e Veriut — vend që si i tillë simbolizon ndërtimin e paqes dhe pajtimin — paraqet faktin se si përvojat e përbashkëta dhe mirëkuptimi i ndërsjellë mund të tejkalojnë përqarjet që vijnë nga historia. Në prapavijë mund të lexohet fjalia “Rinia po ndryshon botën”, e shkruar në serbisht dhe shqip.

Pavarësisht sfidave që shpesh i mbajnë komunitetet të ndara pas konfliktit, të rinjtë vazhdojnë të ndërtojnë lidhje besimi dhe solidariteti, duke na kujtuar se miqësitë dhe bashkëpunimi i tyre janë themeli për një të ardhme më gjithëpërfshirëse dhe paqësore.



Ky është nderimi im modest për miqësitë e "përtej kufinjve" dhe një ilustrim që do të duhet të tregonte se të rinjtë janë duke ndryshuar botën.

KUR URAT NUK MJAFTOJNË

AUTORE: *Ardita Xhemajli*

Mitrovica shpesh përshkruhet si simbol i ndarjes. Për të huajt, është qytet urash, i fotografuar, i debatuar dhe i cituar pafundësisht si provë e asaj që e mban Kosovën të ndarë. Megjithatë, për ata prej nesh që jetojnë dhe punojnë këtu, ura nuk është thjesht një metaforë. Është sfondi i jetës së përditshme, që përcakton se ku studiojnë të rinjtë, nëse e kalojnë urën për punë, si dhe si mbajnë peshën e tensioneve politike që nuk i kanë krijuar vetë.

Si një nga shoqëritë më të reja në Evropë, të rinjtë e Kosovës shpesh lavdërohen si “e ardhmja” dhe “agjentë të ndryshimit”. Këto slogane tingëllojnë optimiste, por në Mitrovicë, shpesh tingëllojnë boshe. Të rinjtë vlerësohen kur shfaqen në fotografi shumetnike ose kur marrin pjesë në ngjarje simbolike, por zëri i tyre rrallë ndikon në politikat që i prekin më së shumti. Pritshmëria që ata të ndërtojnë ura është e lartë, ndërsa mbështetja që marrin për ta bërë këtë mbetet e dobët.

Ngjarjet e fundit të sigurisë, të raportuara gjerësisht në media lokale dhe ndërkombëtare, theksuan edhe një herë paqëndrueshmërinë e mbështetjes ndaj të rinjve. Përtej vetë dhunës, këto ngjarje e forcojnë tek shumë të rinj në Mitrovicë ndjesinë se stabiliteti nuk është kurrë i garantuar. Çdo valë trazirash ose retorikë nacionaliste i shtyn ata më tej drejt tërheqjes e vetëmbrojtjes. Bashkëpunimi është i mundur. Ndodh çdo ditë në klasa, vende pune dhe midis miqve, por është i brishtë dhe lehtësisht i errësuar nga agjendat politike. Këto tensione më të mëdha, politike dhe të sigurisë, shpesh ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme, duke formësuar mënyrën se si përjetohen dhe perceptohen aktivitetet e

e zakonshme rinore. Kjo do të thotë se edhe ngjarjet më të thjeshta për të rinjtë mund të kthehen në hapësira vëzhgimi dhe tensioni.

Aktivitetet e fundit rinore në qytet e ilustrojnë këtë brishtësi. Një turne sportiv, një festival kulturor, apo edhe ndonjë iniciativë e thjeshtë që synon të bashkojë njerëzit mund të politizohet shpejt, të përqafohet në një moment dhe të vihet në pikëpyetje në momentin tjetër. Ato që duhet të jenë hapësira të zakonshme për afrimi, shpesh bëhen teste të besnikërisë ose identitetit. Për shembull, festivali Ndërkombëtar i Ditëve të Xhazit në Mitrovicë, i mbajtur për të tretin vit radhazi në vitin 2025, përfshiu performanca si në jug ashtu edhe në veri të Mitrovicës, si dhe punëtori për talentet e reja. Ndërsa festivali synonte të nxiste angazhimin e komunitetit dhe shkëmbimin kulturor, disa pjesëtarë të komunitetit serb në veri e perceptuan ngjarjen si të motivuar politikisht. Tensionet u shfaqën në Mitrovicën e Veriut kur kryetari i komunës, Erden Atiq, arriti në skenën alternative, duke çuar në protesta dhe pengime të vogla. Organizatorët përfundimisht e hoqën skenën në atë zonë. Incidente të tilla nxjerrin në pah faktin se si iniciativat e përditshme rinore mund të politizohen, duke krijuar një mjedis ku pjesëmarrja mbart rreziqe sociale dhe politike.

Të përballur me këtë lloj mjedisi, shumë të rinj vendosin të tërhiqen nga aktivitetet midis komuniteteve, jo nga mungesa e interesit, por nga brenga. Rreziqet janë reale, presionet të mëdha dhe narrativat politike shpesh dekurajuese. Pranimi i këtij realiteti është thelbësor. Dhe tërheqja, në vetvete, është një formë qëndrueshmërie, një mënyrë për t'u përballur me një mjedis

të vështirë.

Megjithatë, ka edhe të tjerë që bëjnë zgjedhjen e kundërt. Edhe pse i dinë rreziqet, ata vendosin të angazhohen, të kalojnë urën për në shkollë, të punojnë në ekipe të përziera ose të mbajnë miqësi përtej kufijve. Të rinjtë që ndërmarrin këta hapa mund të përballen me pasoja sociale, si pyetje nga bashkëmoshatarët, të etiketohen si të pabesë ose të ndihen të marginalizuar brenda komuniteteve të tyre. Kjo është diçka që e kam vërejtur në Mitrovicë, në të dyja pjesët e qytetit, ku pjesëmarrja në aktivitete ndërkomunitare mund të provokojë kureshtje apo skepticizëm tek të tjerët. Për brezat e të rinjve që filluan të punonin në vitet 2000, sfidat ishin edhe më të mëdha. Ot, rreziqet dhe presionet vazhdojnë të varen kryesisht nga zhvillimet e fundit politike. Megjithatë, shumë të rinj vazhdojnë të hedhin hapa përpara, duke treguar këmbëngulje dhe përkushtim për ndërtimin e lidhjeve pavarësisht pengesave. Qëndrueshmëria e tyre dërgon një mesazh të qartë: bashkëpunimi është i mundur dhe të rinjtë po e formësojnë në mënyrë aktive strukturën shoqërore të qytetit të tyre.

Qoftë ata që zgjedhin të tërhiqen, qoftë ata që vendosin të ecin përpara, të dyja vendimet lindin nga i njëjti realitet kompleks dhe pasqyrojnë zgjedhjet e vështira me të cilat përballen çdo ditë. Si tërheqja, ashtu edhe angazhimi janë pasqyrime të së njëjtës përvojë të jetesës në Mitrovicë — ku çdo ndërveprim kërkon një ekuilibër të vazhdueshëm midis sigurisë personale, presioneve shoqërore dhe dëshirës për të ndërtuar marrëdhënie kuptimplota. Mbështetja institucionale për iniciativat rinore në Mitrovicë është shpesh e kufizuar ose jokonsistente, duke i lënë të rinjtë të përballen me sfidat kryesisht vetë. Premtimet për përfshirje dhe mbështetje mund të shfaqen në raporte ose deklarata politike, por pa vazhdimësi praktike, të rinjtë përballen me skepticizëm, pengesa dhe rrezikun e politizimit të iniciativave të tyre.

Rrëfimi real i Mitrovicës nuk ka të bëjë vetëm me ndarjen. Ka të bëjë me këmbënguljen kundrejt brishtësisë, për të rinjtë që këmbëngulin të krijojnë lidhje edhe kur klima politike i dekurajon. Nëse institucionet dhe aktorët ndërkombëtarë e marrin seriozisht paqen, ata duhet të shkojnë përtej fotografive dhe sloganeve. Mbështetja e të rinjve këtu do të thotë t'i dëgjosh ata, të mbrosh iniciativat e tyre nga politizimi dhe të pranosh që zgjedhjet e tyre të përditshme për të studiuar, për të punuar, për të bashkëpunuar apo edhe për t'u tërhequr, janë të gjitha të formësuara nga i njëjti kontekst i vështirë.

Në Mitrovicë, urat shihen shpesh si simbole bashkimi, por sfida e vërtetë nuk është tek ura vetë, është tek ata që e kalojnë atë. A do të njihen të rinjtë si pjesëmarrës aktivë që po e ndryshojnë qytetin e tyre, apo vetëm si figura në fotografi? Pa mbështetje të qëndrueshme institucionale, përpjekjet e tyre mbeten të brishta. Derisa të ndodhë ky ndryshim, të rinjtë do të vazhdojnë të jetojnë mes dy skajeve, të lavdëruar për të ardhmen, por të padëgjuar në të tashmen.

DITA KUR BOTA NUK ISHTE MË KAFAZ

AUTORE: Hassina Akbari

Krijimi i kësaj pasqyre ishte njëkohësisht edhe sfidë edhe akt mosbindjeje. Si grua afgane dhe refugjate, jetoj me kufizime që shpesh më heshtin ose më kufizojnë. Megjithatë, me çdo lëvizje peneli, zgjidhja të pikturoja ëndrrën që ende e mbaj në zemër.



Kjo vepër pasqyron ëndrrën e grave afgane, ëndërr e qeshjes, e lirisë, e zgjedhjeve që na u mohuan. Vathët me lazul, fustani i kuq i ndaluar dhe dallëndyshet që vallëzojnë në qiell simbolizojnë feminitetin tonë të humbur dhe shpresën tonë të palëkundur për çlirim. Lulekuqja në flokët e saj i bën jehonë si bukurisë ashtu edhe gjakut të sakrificës, ndërsa malet e gjelbra prapa saj pëshpërisin për atdheun që vazhdojmë ta kemi mall.

Për një çast, në këtë pikturë, tretem në atë liri të imagjinuar. Por realiteti shpejt më kujton se lufta nuk ka mbaruar ende. Çdo ditë, sado e vogël, vazhdoj të ec përpara, duke ruajtur besimin se një ditë, kjo ëndërr nuk do të jetë më thjesht një pikturë, por realiteti ynë i jetuar.

ORGANIZOHUNI MË ME ZGJUARSI:

CILAT JANË JEHONAT E FORUMIT STRATEGJIK TË BLEDIT?

AUTOR: Lazar Simić

Slovenia është e qetë, e pastër, e gjelbër, por edhe e guximshme. Përveçse është e damkosur me shumë simpati si i vetmi vend në emër të të cilit mund të ndiesh dashuri (anglisht. I feel Slovenia), ky vend midis Alpeve, Adriatikut dhe Savës mund të jetë gjithashtu krenar për politikën e tij të jashtme të guximshme.

Kjo është ajo që unë, si një nga pjesëmarrësit e rinj, munda të vërej në Forumin Strategjik të Bledit (BSF), i cili u zhvillua jo shumë larg këtij liqeni piktoresk në fillim të shtatorit. Për pothuajse pesëdhjetë prej nesh të rinjve, nga Kina në Argjentinë, ky takim i rëndësishëm gjeopolitik filloi pak më herët - në Forumin Strategjik të të Rinjve të Bledit (YBSF). Pra, "përbërësi" i parë i axhendës së të Rinjve, Paqes dhe Sigurisë (YPS) është këtu - të rinjtë. Do të thoja të rinj punëtorë dhe të motivuar që janë të gatshëm të veprojnë dhe të menaxhojnë të tashmen e shoqërive të tyre dhe këtë shoqëri globale tonën.

Paqja dhe siguria, dhe në praktikë lufta dhe kërcënimet ndaj sigurisë, përshkuan të gjitha bisedat, debatet dhe aktivitetet tona, si gjatë pjesëve zyrtare ashtu edhe në tubimet joformale.

A ishte e planifikuar kjo? Ndoshta jo, por ishte e nevojshme.

Gjërat e para: Kush janë këta të rinj në Bled?

Le të shkojmë me radhë, nga erdhëm dhe cili është qëllimi i YBSF?

"Për të ndarë ide dhe për të gjetur frymëzim

për të përmirësuar komunitetet tona", deklaroi me ambiciozitet por sinqeritet në faqen e internetit të këtij eventi. Si pjesëmarrës në Forumin e këtij viti, konfirmoj se ajo që u shkrua është e vërtetë.

Ekipi i shkëlqyer që drejton këtë Forum mblodhi më shumë se dyzet të rinj nga e gjithë bota, nga prejardhjet më të ndryshme, por me një tipar të përbashkët, që është dëshira për të ndryshuar komunitetet tona për mirë dhe se solidariteti luan një rol të rëndësishëm në këtë. Pjesa rinore e Forumit na lejoi të njiheshim me njëri-tjetrin dhe të lidheshim para se të bashkoheshim me Forumin "e të rriturve". Mos më keqkuptoni, ne jemi tashmë të rritur dhe shpesh shumë seriozë, por jetojmë në një botë ku hapësira për vendimmarrje është ende e ruajtur në mënyrë egoiste. Kush e ruan atë? Disa të rritur të tjerë, por që nuk kanë qenë të rinj për një kohë të gjatë.

Apatikë apo të penguar të kenë një ndikim të përkohshëm?

Ndoshta është sëmundja e çdo brezi të mbivlerësojë rëndësinë e kohës së saj. Ose ai psherëtim rregullisht me mendimin "sa probleme kemi për të zgjidhur" ose beson fuqimisht se diçka po ndodh për herë të parë në histori edhe pse është parë tashmë (por harruar).

Ndoshta në fund të fundit nuk është kështu. U habita kur një nga pjesëmarrësit, Ricky nga Kroacia, iu përgjigj me takt akuzës së një zotërie më të vjetër se të rinjtë janë apatikë dhe se ne nuk duam të merremi me shoqërinë tonë. Si një i ri nga Serbia, ku të

rinjtë, kryesisht studentët, kanë treguar gjithçka përveç apatisë për dhjetë muaj, u shokova, për ta thënë butë, nga kjo deklaratë.

Për qëllimet e këtij shkrimi, nuk është e rëndësishme të thuhet se kush na karakterizoi si apatikë. Përgjigja është e rëndësishme: "Na e latë botën në një gjendje shumë më të keqe sesa e morët nga prindërit tuaj", dhe unë shtoj, "nuk na jepni hapësirë të mjaftueshme për të vepruar". Kjo është arsyeja pse zbatimi i axhendës së Rinisë, Paqes dhe Sigurisë është i rëndësishëm. Rezoluta 2250, e miratuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në vitin 2015, njeh që "të rinjtë duhet të përfshihen aktivisht në formësimin e paqes së qëndrueshme dhe arritjen e drejtësisë dhe pajtimit". Sllovenia tregon se e kupton pse kjo është e rëndësishme vite më parë. Kjo është arsyeja pse, pranë Forumit Strategjik të Bledit, u krijua ky Forum Rinor.

"Të rriturit" ende e ruajnë me xhelozë hapësirën e tyre.

Forum i në tërësinë e tij është një mjet i politikës së jashtme sllovene, kjo nuk është sekret. Ai e pranon se është e rëndësishme të përfshihen të rinjtë që nuk janë një lloj "udhëheqësish të së ardhmes", por agjentë të sotëm. Dhe kjo duhet të përsëritet si një papagall.

Një pjesë e narrativës se të rinjtë janë e ardhmja është (vetë) mashtruese dhe mund të jetë shumë e rrezikshme. Edhe pse ka kuptime të mira të kësaj banaliteti, ka edhe nga ata që qëllimisht theksojnë se ne jemi e ardhmja sepse atëherë pyesim veten - por vetëm në të ardhmen. Deri atëherë, treni kalon nëpër misër, siç thonë në gjuhën serbe.

Disa nga kolegët e mi u zhgënjyen me të drejtë nga hapësira për pyetje, komente dhe pjesëmarrje aktive në vetë Forumin e Bledit. Fjala kryesore u mbajt nga përfaqësuesit më të lartë politikë,

politikanë, diplomatë, gjeneralë, gazetarë tashmë të emancipuar. Dhe kjo, të paktën për mua, nuk ishte një surprizë. Ne e dimë se organizatorët e seksionit të Rinjve të forumit bënë çmos që të na përfshinin ne të rinjtë sa më shumë dhe në mënyrë kuptimplote të ishte e mundur.

Ajo që kemi sot është sigurisht më shumë sesa kishin disa të rinj të tjerë 5, 10 ose 15 vjet më parë. Nuk ka nevojë të flasim për kohën para kësaj. Po kështu, ajo që kemi sot ende nuk është e mjaftueshme.

Të rinjtë ende e pushtojnë hapësirën që u takon atyre

Kur flasim për ndërtimin e paqes së qëndrueshme, dhe shtojmë se ajo duhet të jetë pozitive, jo vetëm mungesa e luftës dhe dhunës, atëherë të rinjtë janë çelësi - që tani.

Frazat e përsëritura shpesh "të rinjtë janë e ardhmja" dhe "të lejojmë zërin e të rinjve të dëgjohet" janë të zbrazëta nga përmbajtja dhe të bllokuara në potencial.

Në kohën e shkrimit, pjesa më e madhe e vëmendjes së botës është përqendruar në Nepal. Lexojmë tituj rreth "Gjeneratës Z" që rrëzon qeverinë sepse donte të ndalonte mediat sociale, por edhe për shkak të korrupsionit të thellë në vendin Himalayan.

Të rinjtë, ose Gjenerata e famshme Z, të cilës i përkas edhe unë, janë qytetarë në të njëjtën kohë, njësoj si të gjithë të tjerët. Apo ka diçka që na dallon?

Ajo që është një avantazh i brezit tonë është se ne jemi vendas dixhitalë dhe se jemi më të shkolluar në media, dixhitale dhe informacion sesa disa breza më të vjetër. Ne nuk jemi domosdoshmërisht më të zgjuar ose më të arsimuar, por tre sekondat thelbësore të vëmendjes na kanë formësuar të mendojmë ndryshe dhe të veprojmë më shpejt. Ne e njohim përmbajtjen e gjeneruar artificialisht shumë më lehtë se

disa të tjerë, dhe i shohim rrjetet sociale jo vetëm si një vend për argëtim, por edhe për informacion në kohë dhe të menjëhershëm.

Nëse pranojmë se diçka është ndryshe në brezin tonë (të rinjtë janë 18-29 vjeç sipas axhendës së Rinisë, Paqes dhe Sigurisë), atëherë pranojmë se të rinjtë mund të luajnë një rol vendimtar në ndryshimet e nevojshme nga shoqëria njerëzore si e tillë.

E ardhmja është në unitet.

Le të kthehemi te Sllovenia dhe Bledi. Një nga përshtypjet më të forta që kam pas Forumit Strategjik të Bledit është mesazhi nga shteti slloven se vendet e vogla duhet të bashkëpunojnë. Ato duhet të bashkëpunojnë sepse së pari e kuptojnë vlerën e paqes dhe sigurisë, të cilën shpesh nuk mund ta ofrojnë vetë, të parë individualisht.

Mendoj se brezat e të rinjve që po pushtojnë hapësirën që na takon e kuptojnë gjithashtu se sa i rëndësishëm është uniteti dhe solidariteti. Falë rrjeteve sociale, ose më saktë lidhjes sonë me to, idetë nuk janë

ndarë kurrë më shpejt, dhe solidariteti përsëri duket si një fenomen i gjallë, jo një koncept arkaik. Është koha që veprimet e individëve, të formave të ndryshme të komuniteteve, por edhe të shteteve që duan paqe, të jenë të koordinuara dhe të qëndrueshme. Një peshk i vogël do të mbrohet vetëm kundër një peshku të madh në një tufë me peshq të tjerë të vegjël. Ose siç thonë me zgjuarsì studentët serbë:

"Ai më i zgjuar organizohet vetë."

A mund t'i Përputhni Fjalët e Pages?

TERMAT

AGJENCIA

NDËRMJETËSIMI

PAJTIMI

SOLIDARITETI

FUQIZIMI

PËRKUFIZIME

Mbështetja ose uniteti midis individëve me qëllime të përbashkëta

Arritja e marrëveshjeve dhe ndërtimi i besimit pas konfliktit ose

Procesi i fitimit të besimit, kontrollit dhe aksesit në burime

Fuqia ose aftësia e individëve për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe për të bërë zgjedhje

Një metodë për zgjidhjen e konfliktit përmes diskutimit të lehtësuar

HESHTJA E SIKLETSHME E PANELEVE TË TË RINJVE NË PAQE

AUTORE: ALBA JAKUPI

Zakonisht fillon me gëzim. Merr një ftesë me email me të gjitha fjalët e duhura: Rini, Paqe, Siguri dhe Pjesëmarrje. Ka aq shumë logo në fletushkë sa të bën të të merren mend. Eventi do të zhvillohet ose në një sallë konferencash hoteli me llambadarë ose në një qendër kulturore që duket pak e zbehtë dhe ka mikrofonë të thyer. Emaili thotë, "zërat e të rinjve do të jenë në qendër të këtij diskutimi".

Pastaj e vërteta të godet: arrin atje, ulesh në audiencë dhe kupton se "pjesëmarrja e të rinjve" do të thotë të jesh majdanozi dekorativ në pjatën institucionale.

Le të përgatisim skenën për një panel tipik paqeje në Ballkan. Tre ambasadorë, dy zyrtarë qeveritarë, një profesor universiteti dhe një përfaqësues i të rinjve të gjithë të shtrydhur në cep të tryezës pas disa

negociatave të sjellshme. Pas nëntëdhjetë minutash fjalimesh rreth "të rinjve si e ardhmja", moderatori më në fund të shikon dhe thotë, "Tani do t'ia japim fjalën pjesëmarrësit tonë të ri".

Mikrofoni duket plot kuptim dhe peshë. Keni saktësisht tre minuta për të folur për "të rinjtë e [vendosni vendin që dëshironi]". Sigurisht, nuk ka presion.

Merrni frymë, theksoni se sa e rëndësishme është të kaloni nga gjestet simbolike në ndryshime të vërteta dhe ndoshta edhe të ndaloni së përdoruri shprehjen "pjesëmarrje kuptimplote" për më mirë. Publiku përkul kokën me mirësjellje. Pastaj një ambasador shpejt jua kthen mikrofonin, ju falënderon dhe vazhdon të shpjegojë se çfarë duan vërtet të rinjtë. Ironia është aq e trashë sa mund ta prisni me thikë.



BALLKANI: KU PANELET RINORE JANË SI RIBASHKIME FAMILJARE

Panelet e paqes në Ballkan shpesh janë si ribashkime familjare. Burri i moshuar që thotë "gjërat ishin më mirë në kohët e vjetra", tezja që citon ligjin ndërkombëtar sikur të ishte një recetë dhe kushërirri që shikon me nervozizëm orën sepse dreka do të vonojë. Të rinjtë janë fëmijët në tavolinë: ata tolerohen, ndonjëherë qeshen, por rrallë merren seriozisht.

Po sikur të rinjtë më në fund të flasin? Shumë herë, reagimet janë të pahijshme, si "Kaq elokumente! Perspektiva kaq të freskëta!" sikur të mendonin se do të xhonglonit në vend që të flisnit. Jeta reale e të rinjve, nga ana tjetër, lihet me mirësjellje jashtë bisedave "serioze". Këto përfshijnë papunësinë, zhvendosjen në një vend të ri, mosbesimin midis grupeve etnike dhe rritjen e politikës së TikTok.

Titulli i këtij artikulli vjen nga ai moment i sikletshëm kur të gjithë heshtin pas një ndërhyrjeje të të rinjve. Jo sepse ajo që thatë ishte e keqe, por sepse paneli nuk di si të përgjigjet. Ideja juaj që të rinjtë duhet të jenë pjesë e organeve vendimmarrëse nuk përputhet me mënyrën se si i kanë planifikuar gjërat. Kështu që, në vend të kësaj, ata përkulin kokën, buzëqeshin dhe largohen shpejt.

Kjo qetësi është më shumë sesa thjesht të qenit i pakëndshëm pranë njerëzve të tjerë. Ajo tregon një problem strukturor: pjesëmarrja e të rinjve shpesh vendoset si një performancë në vend të një partneriteti. Institucionet janë të vetëdijshme se ata duhet të shihen me të rinjtë. Por t'u japësh vërtet të rinjve pushtet? Kjo është shumë më e rrezikshme sesa t'i lejojnë ata të bëjnë pyetjen e fundit të ditës.

Axhenda e të Rinjve, Paqes dhe Sigurisë, e cila filloi me Rezolutën 2250 (2015) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, u përpoq ta zgjidhte pikërisht këtë problem. Rezoluta theksoi se të rinjtë

nuk janë vetëm përfitues të ndërtimit të paqes, por edhe partnerë dhe udhëheqës. Rezolutat pasuese të saj, 2419 (2018) dhe 2535 (2020), theksojnë edhe më shumë nevojën për të përfshirë sistematikisht zërat e të rinjve në politikë. Por në praktikë, fryma e këtyre rezolutave shpesh reduktohet në një seancë të vështirë pyetje-përgjigje.

KUR HESHTJA SHNDËRROHET NË REBELIM

Të rinjtë e Ballkanit e kanë zotëruar humorin si mjet mbijetese. Kur u duhet të merren me panele që i bëjnë të duken të sjellshëm, ata i drejtohen satirës. Njerëzit në Prishtinë bëjnë shaka se nëse u kërkohet të jenë në një panel tjetër rinor, do të shënojnë "Pjesëmarrës Profesional" në CV-në e tyre. Studentët në Beograd bëjnë shaka se mënyra më e mirë për t'u kujtuar të aplikoni për viza në Gjermani është të zhvilloni diskutime në panel rreth të ardhmes së tyre. Kjo pjesë humoristike nuk është thjesht të qenit cinik. I ndihmon njerëzit të merren me gjërat. Të rinjtë rifitojnë një ndjenjë kontrolli duke qeshur me absurditetin. Nëse sistemi i shndërron në spektatorë, ata e kthejnë shfaqjen përsëri në sistem.

